



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***30 Janar - 01 Shkurt 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



# TETOVA

shpejt dhe ndryshe

## Personave me të ardhura të ulëta automatikisht do t'u vazhdohet sigurimit shëndetësor



Personat me të ardhura të ulëta të cilët vitin e kaluar kanë realizuar të ardhura neto nën 115.080 denarë nuk ka nevojë të vijnë në shërbimin rajonal të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë që të reregjistrohen, sepse sigurimi i tyre shëndetësor automatikisht do të vazhdohet. Limiti sipas të cilit qytetarët e realizojnë këtë të drejtë shënon rritje të vazhdueshme prej 69.600 denarë në vitin 2014 deri në 115.080 denarë sot, që është pasojë e rritjes së pagesës minimale, njofton MIA.

Këtë sot në konferencë për shtyp e theksoi drejtori i FSSHMsë Sasho Stefanovski, i cili tha se Fondi automatikisht do t'i reregjistrojë edhe personat të cilët gjatë dy muajve të fundit të vitit kanë realizuar të ardhura më të ulëta se 19.180 denarë dhe që janë në kategorinë e personave të siguruar të cilët kanë realizuar të ardhura prej 115.080 deri në 193.608 denarë gjatë vitit të kaluar.

Dy kategoritë tjera të personave të siguruar të cilët paguajnë 50 për qind ose 100 për qind nga kontributi shëndetësor të pagesës minimale, nëse janë në korniza të limitieve 115.080 denarë deri në 193.608 denarë, theksoi Stefanovski, gjithashtu nuk është e nevojshme të vijnë që të reregjistrohen në sportelet e shërbimeve rajonale të Fondit.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Shtoi se njëherit edhe personat të cikët kanë ndryshim në vlerën e të ardhurave neto, është e nevojshme të vijnë në shërbimet rajonale të Fondit nga 1 shkurti deri më 31 mars dhe të sjellin dokumente për reregjistrim të ri.

Drejtori i FSSHMsë Orhan Ramadani tha se si të ardhura të familjes konsiderohen të ardhurat personale dhe të ardhurat e anëtarëve të bartësit të sigurimit shëndetësor (burri/gruaja, fëmijë).

Nga 115.080 denarë deri 193.608 denarë nëse gjatë dy muajve të fundit të siguruarit kanë realizuar më pak të ardhura se 19.180 denarë, theksoi, sigurimi shëndetësor është në barë të shtetit, gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë do të paguajë kontribut për sigurimin shëndetësor, rritja këtë vit e limitit ligjor të kësaj kategorie në krahasim me vitin e kaluar është 9.480 denarë.

Shtoi se për të gjitha informacionet më detajisht lidhur me Projektin për regjistrimreregjistrim të personave të papunë, të siguruarit mund të drejtohen në info linjën falas 0800 33 22 ose në email adresën [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk) si dhe në ueb faqen [www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk) në pjesën e reregjistrimit të personave me të ardhura të ulëta.



## Todorov dhe Selmani në TOARSHIQU janë investuar 45 milion denarë



Ministria e Shëndetësisë ka furnizuar me pajisje të reja më bashkëkohore në vlerë të tërësishme prej mbi 45 milionë denarësh...

Ministria e Shëndetësisë ka furnizuar me pajisje të reja më bashkëkohore në vlerë të tërësishme prej mbi 45 milionë denarësh, Klinikën universitare për traumatologji, ortopedi, anesteziologji dhe reanimacion, shërim intensiv dhe Qendër urgjente.

Kështu dekalroi ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov gjatë vizitës së sotme në Klinikë, me çrast potencoi edhe renovimin e sallave të operacioneve dhe një pjesë për shërim gjysmëintensiv.

*"Pajisja shfrytëzohet edhe nga ana e mjekëve tanë dhe nga mjekët nga vendet e huaja të cilët vijnë dhe së bashku punojnë me mjekët tanë. Kryesisht janë mjekë nga Turqia dhe Sllovenia. Punohen në procedura komplekse dhe të shtrenjta, ndërsa veçanërisht e rëndësishme është aparati i ri për neuromonitorim me të cilin mundësohet parandalimi dhe parandalohen lëndimet në palcën kurrizore gjatë operacionit dhe me atë zvogëlohet mundësia për komplikime dhe gabime mjekësore serioze",* theksoi Todorov.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)


Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Drejtori i Klinikës Rexhep Selmani tha se me kompletimin e qendrës spinale dhe me pajisjen e re, numri i pacientëve që trajtohen është dukshëm më i madh.

**"Trajtohen pacientët me problematikën e kirurgjisë spinale, si fraktura dhe trauma në shtyllën kurrizore, ndryshimet degjenerative dhe deformimet dhe sëmundje të tjera"**, theksoi Selmani, sipas të cilit tanimë këtu praktikohen mjaft operacione të komplikuar, të cilat bëhen me ndihmën e mjekëve nga jashtë.

## Mjekët: Ndryshimi i temperaturës dëmton shëndetin



**Ndryshimet e shpeshta të temperaturës gjatë stinës së dimrit, janë shkaktar i paraqitjes së virozave dhe ftohjes...**

Probleme në organizëm mund të shkaktohen edhe nga ekspozimi i trupit në temperatura të ndryshme brenda një kohe të shkurtër, thonë mjekët.

Sipas tyre përshtajta e organizmit ndaj ndrrimit të ambienteve me temperatura të ndryshme duhet të bëhet në bazë të asaj që konsiderohet si temperaturë normale nga 20 deri më 30 grade celsius.

**"Temperatura normale dmth ku ne mundemi të gjitha aktivitetet tona ti zhvillojmë normal dhe metabolizmi jonë të mos përfitojë ndonjë ndryshim, të pësojë, ajo është temperaturë mbi 20 gradë. Cdo temperaturë me 20 gradë dmth në hapsirën ku jetojmë për hapsirën ku jetojmë ose dhomën ku jetojmë duhet të jetë prej 20 deri më 30 gradë; Proceset metabolitike në organizmin tonë, atëherë janë normale, mundemi të punojmë, funksionojmë normal. Nëqoftëse temperatura për një kohë të shkurtë bën ndrim mbi 25 gradë, ndrim të përnjëhershëm, prej kësaj dhome ku është temperature 30 gradë, dalim në në temperature 0 gradë, atëherë organizmi jonë reagon aq shumë saqë qendra e termorregullacionit në trurin, nuk mund mirë ta kontrollojë metabolizmin"**, tha dr. Muhamet Kamberi, specialist internist.

Temperatura trupore prej 36 deri me 37 grade është temperaturë bazale që një organizëm të mund të funksionojë normalisht dhe cdo temperaturë që zbret nën 35 grade sjell ndryshime në organizëm me cka me uljen e temperaturave ngadalsohet edhe puna e gjithë organeve, kurse pasojat fatale edhe me vdekje vijnë me temperaturë trupore nën 24 gradë celsius.

Por mjekët rekomandojnë që ambienti në të cilin bëjmë gjumë të jete me temperaturë nën 20 gradë Celsius.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Dr.Muhamet Kamberi: Ndryshimi i temperaturës dëmton shëndetin

**Shkup, 30 janar** - Ndryshimet e shpeshta të temperaturës gjatë stinës së dimrit, janë shkaktar i paraqitjes së virozave dhe ftohjes.

Probleme në organizëm mund të shkaktohen edhe nga ekspozimi i trupit në temperatura të ndryshme brenda një kohe të shkurtër, konsideron mjeku, dr.Muhamet Kamberi, specialist internist.

Sipas tij përshtajta e organizmit ndaj ndryshimit të ambienteve me temperatura të ndryshme duhet të bëhet në bazë të asaj që konsiderohet si temperaturë normale nga 20 deri më 30 grade celsius.

**“Temperatura normale dmth ku ne mundemi të gjitha aktivitetet tona ti zhvillojmë normal dhe metabolizmi jonë të mos përfitojë ndonjë ndryshim, të pësojë, ajo është temperaturë mbi 20 gradë. Cdo temperaturë me 20 gradë dmth në hapsirën ku jetojmë për hapsirën ku jetojmë ose dhomën ku jetojmë duhet të jetë prej 20 deri më 30 gradë; Proceset metabolitike në organizmin tonë, atëherë janë normale, mundemi të punojmë, funksionojmë normal. Nëqoftëse temperatura për një kohë të shkurtër bën ndrim mbi 25 gradë, ndrim të përnjëhershëm, prej kësaj dhome ku është temperature 30 gradë, dalim në në temperature 0 gradë, atëherë organizmi jonë reagon aq shumë saqë qendra e termorregullacionit në trurin, nuk mund mirë ta kontrollojë metabolizmin”,** tha dr.Muhamet Kamberi, specialist internist.

Temperatura trupore prej 36 deri me 37 grade është temperaturë bazale që një organizëm të mund të funksionojë normalisht dhe cdo temperaturë që zbret nën 35 grade sjell ndryshime në organizëm me cka me uljen e temperaturave ngadalsohet edhe puna e gjithë organeve, kurse pasojat fatale edhe me vdekje vijnë me temperaturë trupore nën 24 gradë celsius.

Por mjekët rekomandojnë që ambienti në të cilin bëjmë gjumë të jete me temperaturë nën 20 gradë Celsius.

## Mbi 45 milionë denarë janë investuar në pajisjen e re të klinikës TOARSHIQU

**Shkup, 30 janar** - Ministria e Shëndetësisë në Klinikën universitare për traumatologji, ortopedi, anesteziologji dhe reanimacion, shërim intensiv dhe Qendër urgjente (TOARSHIQU) furnizoi pajisje të re me bashkëkohore në vlerë të tërësishme prej mbi 45 milionë denarësh, deklaroi sot ministri Nikolla Todorov.





FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Todorov gjatë vizitës së sotme në Klinikën për TOARSHIQU theksoi se pajisja e re e furnizuar veçmë shfrytëzohet në Klinikë, si dhe se paraprakisht janë renovuar sallat e operacioneve dhe një pjesë për shërim gjysmë intensiv.

"Pajisja shfrytëzohet edhe nga ana e mjekëve tanë dhe nga mjekët nga vendet e huaja të cilët vijnë dhe së bashku punojnë me mjekët tanë. Kryesisht janë mjekë nga Turqia dhe Sllovenia. Punohen në procedura komplekse dhe të shtrenjta, ndërsa veçanërisht e rëndësishme është aparati i ri për neuromonitorim me të cilin mundësohet parandalimi dhe parandalohen lëndimet në palcën kurrizore gjatë operacionit dhe me atë zvogëlohet mundësia për komplikime dhe gabime mjekësore serioze", theksoi Todorov.

Sipas Todorov, bëhet fjalë për pajisje të tërësishme të furnizuar në vlerë prej mbi 45 milionë denarësh, paraprakisht 30 milionë dhe tani edhe 14,5 milionë denarë, e cila veçmë është vendosur në funksion dhe shfrytëzohet nga ekipet mjekësore të klinikës.

"Kjo klinikë ka buxhet jashtëzakonisht të rritur në krahasim me vitin paraprak dhe atë është rritur për 50 milionë denarë. Ajo do të mundësojë funksionim më të mirë të klinikës nga aspekti financiar dhe mundësi për sjellje të metodave të reja", theksoi Todorov. Buxheti i tërësishëm i Klinikës këtë vit është rreth 443 milionë denarë.

Drejtori i TUORU Rexhep Selmani tha se me kompletimin e qendrës spinale dhe me pajisjen e re të pacientëve që trajtohen është dukshëm më i madh.

"Vitin e kaluar numri është rritur në 121 intervenime. Trajtohen pacientët me problematikën e kirurgjisë spinale, si fraktura dhe trauma në shtyllën kurrizore, ndryshimet degjenerative dhe deformimet dhe sëmundje të tjera", theksoi Selmani, duke shtuar se veçmë këtu praktikohen mjaft operacione të komplikuara, të cilat bëhen me ndihmën e mjekëve nga vendet e huaja.

**Koha**  
E PËRDITSHME INFORMATIVE

## Personave me të ardhura të ulëta automatikisht do t'u vazhdohet sigurimi shëndetësor

Shkup, 31 janar - Personat me të ardhura të ulëta të cilët vitin e kaluar kanë realizuar të ardhura neto nën 115.080 denarë nuk ka nevojë të vijnë në shërbimin rajonal të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë që të reregistrohen, sepse sigurimi i tyre shëndetësor automatikisht do të

vazhdohet. Limiti sipas të cilit qytetarët e realizojnë këtë të drejtë shënon rritje të vazhdueshme prej 69.600 denarë në vitin 2014 deri në 115.080 denarë sot, që është pasojë e rritjes së pagës minimale. Këtë vendin e ka sjellë FSSHM, sipas të cilës, Fondi automatikisht do t'i reregjistro-

jë edhe personat të cilët gjatë dy muajve të fundit të vitit kanë realizuar të ardhura më të ulëta se 19.180 denarë dhe që janë në kategorinë e personave të siguruar të cilët kanë realizuar të ardhura prej 115.080 deri në 193.608 denarë gjatë vitit të kaluar. Dy kategoritë tjera të personave të siguru-

ar të cilët paguajnë 50 për qind ose 100 për qind nga kontributi shëndetësor të pagesës minimale, nëse janë në korniza të limitieve 115.080 denarë deri në 193.608 denarë, gjithashtu nuk është e nevojshme të vijnë që të reregistrohen në sportelet e shërbimeve rajonale të Fondit.





FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



Situatë epidemiologjike në muajt kritike

# 350 persona të prekur nga gripi


Situatë epidemiologjike gjatë dy javëve të fundit në rajonin e Gostivarit flet për rritje drastike të numrit të të sëmurëve. Deri më tani janë regjistruar shumë raste të reja. Nga Enti epidemiologjik në Gostivar njoftuan se shumica e tyre janë paraqitur gjatë gjithë muajit janar

Koha

Driton ZENKU

Gostivar, 31 janar -Fundi i muajt janar shënon rritje drastike të të sëmurëve nga gripi në regjionin e Gostivarit. Deri më tani janë regjistruar 350 raste të reja. Nga enti epidemiologjik në Gostivar, njoftuan se shumica e tyre janë paraqitur gjatë gjithë muajit janar.

"Situatë epidemiologjike gjatë dy javëve të fundit flet për rritje drastike të numrit të të sëmurëve. Mendoj se grip në regjionin tonë tani e ka marrë hovin dhe besoj se javët të vazhdim do ta ndjekin trendin në rritje të të prekurve nga gripi", deklaroi përgjegjësi i entit epidemiologjik në Gostivar, Vojsllav



Ognjanovski. Moshë më e prekur nga gripi llogaritet të jetë nga 15 deri 64 vjeçare.

Megjithatë, ndryshe nga viti i kaluar kur serioziteti i gripit disa persona i çoi në gjendje të rëndë shëndetësore, kësaj radhe nuk është shënuar ndonjë rast me përkeqësime më serioze shëndetësore.

"Nga gjithsej 350 raste nga numri i përgjithshëm, fatmirësisht deri më tani nuk kemi pasur fëmijë nën moshën 4 vjeçare. I vogël është edhe numri i të prekurve nga moshë 5 deri 14 vjeçe. Në këtë grup kemi gjithsej 27 raste. 24 raste i përkasin moshës mbi 65

vjeçare" sqaron Ognjanovski.

Por, numrat e evidentuara nga qendra epidemiologjike në Gostivar, nuk janë përfundimtare, për arsye se i madh është numri i pacientëve që trajtohen edhe në mjekësinë primare, por shumë më i madh është numri i atyre që nuk paraqiten aspak në mjek.

Pasi ndodhemi në periudhën e përshtatshme për shtim të rasteve të prekura nga gripi, mjeku apelon për kujdes sidomos tek grupet më të rrezikuara si që janë, fëmijët, gratë shtatzëna dhe të sëmurët kronik që të mos presin të vinë në shprehje komplikimet sepse në këtë

formë, rrezikojnë që gjenden e tyre ta përkeqësojnë deri në rrezik për jetë.

Ognjanovski nënvizon se gripi megjithatë është një sëmundje e rëndë, sidomos nëse paraqitet në formë të epidemisë apo pandemisë.

Në rrethana të këtyra, mund të shkaktojë komplikime serioze në mushkëritë e bardha, zemrën, ndezje të veshëve, sinuseve etj. Hapësira të mbyllura vazhdimisht të ajrosura, lëngje të ngrohta dhe freskuese me vitamina, pemë, shmangja e vendeve të mbyllura dhe të populluara dhe mbi gjitha higjiena personale dhe mjedisore, janë ndër këshillat primare që kompetentët nënvizojnë për të prevenuar infektimin që mund të vijë nga virozët që janë aktive dhe të përhapura në mesin e popullatës gjatë kësaj periudhe të vitit, e cila karakterizohet sidomos nga infeksionet respiratore. Befasi nuk paraqet rritja eventuale e numrit të personave që vuajnë nga sëmundjet të rrugëve të sipërme të organeve të frymëmarrjes, pasi këto sëmundje vijnë në një kohë normale për periudhën e vitit në të cilën ndodhemi.